



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.149, datë 16.06.2023

PËR

“CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.139, DATË 07.06.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenet 159, pika 2, 190, pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 47 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Rregullores “Për për procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, nenin 9, pika 4, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të shpallur me vendimin Nr.139, datë 07.06.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 - a. Për zotën Abaz Muça caktohet relator zonja Nurihan Seiti
 - b. Për zotën Urim Buci caktohet relator zonja Ledina Riza
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 16.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elvida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

